



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __.__.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS- "Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të organizimit të eventeve kulturore – 79952100-3; Shërbime të organizimit të festave– 79954000-6; Shërbime organizimi të ngjarjeve sportive– 92622000-7;

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 283 000 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh.

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Dokumentuar me relacionin e KLLFLST nr.4899/5prot, datë 29.06.2026. .

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit (E HAPUR E THJESHTUAR) është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar në sektorin klasik, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”nenin 49 ;në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenin11, pika 1, gërma b) dhe neni 55,74,77 i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 331 datë 13.05.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 291, datë 15.5.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” kreu II pika 2/b .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST-së.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 i ndryshuar; si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.i ndryshuar

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9 dhe 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar; nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës e përkatësisht:

1 313 200 lekë pa tvsh.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit "**Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit**", pika 3 e nenit 77 të LPP i ndryshuar dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit neni 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5,

datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 si dhe **këstet e maturuara të vitit 2026**, (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2026.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se **656 600 lekë**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes *ku shënohen datat, shumat* ,të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe dhe shërbimet e realizuara .****

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ,; dhe në nenin 55, pika 4/ b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër levrimin e shërbimeve të sipas grafikut të levrimit të shërbimeve bashkëngjitur preventivit shtojca 7 e DST-së.

Argumentimi:Me anë të kësaj deklarate synohet OE do te jete i gatshem të kryeje realizimin e shërbimeve sipas grafikut të levrimit në kohë dhe pa problematika, gjatë zbatimit të kontratës

2.3.3- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" si dhe përcaktimet e pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës

2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. **Argumentimi** :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor,**nr.68,datë.30.06.2026**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është:**"Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit"**, me fond limit prej: **3 283 000 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh,lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public, i ndryshuar”. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP . Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE: SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Banket:

Të përfshijë pije, gatime të ndryshme me dy pjata dhe ëmbëlsira, në bizneset e zonës.

2. Stilolapsa me logo:

Të jenë me logon e Bashkisë Roskovec dhe me emërtim sipas kërkesës.

3. Kokteil:

Të përfshijë pije, fruta të thata, ushqime të ëmbla dhe të kripura dhe të shërbehen në vendin sipas kërkesës.

4. Çanta rrobe me logo:

Çanta rrobe prej materiali cilësor, me logon e Bashkisë, sipas kërkesës.

5. Libra/ dhurata për fëmijë:

Libra edukues sipas moshës së kërkuar, dhurata të ndryshme, ëmbëlsira për fëmijë, të paketuara .

6. Transport:

Transport me kapacitet për 20 persona, për çdo udhëtim deri në 12 km.

7. Kafe:

Ekspres.

8. Këngëtar:

Këngëtarë nga treva të ndryshme, me fokus zonën e jugut, të kenë marrë pjesë në festivale dhe koncerte të mëdha dhe të kenë mbi 5 milionë klikime në YouTube për disa këngë të repertorit të tyre.

9. Kupë:

Për skuadrat fituese të aktiviteteve, sipas kërkesës.

10. Shpërblime për artizanët / kulinarinë:

Gra të zonës me gatime tradicionale

11. Kostume animatorësh:

Kostumet duhet të jenë profesionale, prej materiali cilësor sipas miratimit nga Autoriteti Kontraktor

12. Juria për konkursin e festivalit “Stephanophana”:

Juria duhet të jetë e përbërë nga profesionistë në ese, video dhe shkrimtarë me emër sipas kërkesës nga autoriteti kontraktor

13. Moderator:

Me eksperiencë në spektakle të njohura dhe sipas miratimit nga organizatorët

14. Shkrimtarë / Lektorë:

Sipas kërkesës dhe nevojave të aktivitetit.

15. Shkrimtar te njohur

Shkrimtarë të njohur që do të jenë pjesë e panelit të festivalit stephanophana sipas miratimit nga organizatorët

Baner:

Me përmasa 6 m × 4 m, sipas kërkesës dhe përshkrimit të aktivitetit.

16. Poster kartoni:

Sipas kërkesës, me përmasa 2 m × 2 m, material kartoni.

17. Ujë:

Ujë natyral 0.5 L.

18. Aktor:

Aktor te njohur te teatrit për të marrë pjesë me recitime në aktivitetin “Stephanophana”.

19. Vlerësim për konkursin “Stephanophana”:

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 100 000 lekë për personin që shpallet fitues.

20. Vlerësim – Eseja më e mirë:

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin.

21. Vlerësim – Videoja më e mirë:

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin.

22. Certifikata me kapak:

Material cilësor.

23. Humorist:

Të ketë marrë pjesë në spektakle televizive.

24. Korniza dekorative:

Brenda saj të vendoset skulptura “Vajza Myzeqare”, e marrë pranë Bashkisë.

25. Skenë + Foni + Ndriçim + Ekran LED:

Skenë me përmasa 7 m × 8 m, që përfshin 25 bokse për mbulimin e muzikës në ambiente të hapura, ndriçim LED, 8 robotë me efekte të veçanta dhe ekran LED sipas përmasave të skenës.

26. Medalje për fituesit e aktiviteteve:

Me pllakë me emërtim sipas kërkesës

27. Vlerësim për fituesit e Kupës “24 Korriku”:

Vlera e pandryshuar: 15 persona × 75 000 lekë për person.

28. Arbitra (futboll):

Sipas kalendarit të miratuar për një muaj.

29. Lektor:

Sipas kërkesës dhe nevojave të autoritetit kontraktor.

30. Degustues vaji ulliri:

Të kenë eksperiencë në degustimin e vajit të ullirit dhe të jenë të certifikuar.

31. Vlerësim për fituesit e vajit të ullirit:

Vlera e pandryshuar: 5 000 lekë.

32. Poster plastik:

Sipas kërkesës, material plastik me permasa 2 me 2 m

33. Vaj ulliri:

Vaj ulliri cilësor i zonës.

34. Shpërblim për fituesit (sporti):

Vlera e pandryshuar: 3 persona $\times$ 10 000 lekë, si shpërblim për aktivitetin e maratonës së vrapimit.

35. Medalje “Njeriu i Vitit”:

Medalje druri e veshur me kamosh, me pllakë ngjyre ari dhe mbishkrim sipas kërkesës.

36. Spektakël fishekzjarresh:

Të ketë mbi 100 shkrepje të llojeve të ndryshme, në orën 00:00, pranë Bashkisë Roskovec, si dhe person përgjegjës për ndezjen e tyre në datë 31/12/2026.

37. Vlerësime për fituesit e “Njeriut të Vitit”:

Vlera e pandryshuar: 13 tituj $\times$ 5 000 lekë për person.

38. Roll-Up:

Me mbishkrim sipas kërkesës.

39. Kuti druri dhe shishe vaj ulliri:

Kuti druri për shishe 750 ml, me shishe qelqi dhe kuti të personalizuar me logon e Bashkisë.

40. Medalje “Qytetar Nderi”:

E gdhendur në dru, me mbishkrim dhe dizajn të personalizuar sipas kërkesës.

41. Komisioner:

Për numërimin e votave për aktivitetin “Njeriu i Vitit” 2026, persona nga fusha të ndryshme të zonës.

42. Skulptura “Vajza Myzeqare”:

Material i larë në bronz, sipas mostrës që do të merret nga autoriteti kontraktor.

43. Libër “Stephanophana”:

Sipas kopjes që do të merret nga autoriteti kontraktor, 100 faqe plus kopertina.

Shënim:

Mallrat dhe shërbimet do të lëvrohen gjatë gjithë vitit, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Argumentim: Anëtarët pranuam specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posaçëm :KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike) i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.4899prot,datë 26.06.2026,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat/shërbimet që do të kryhen.:Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes konkretisht nga KLLFLST ,dorëzuar dokumentacioni teknik si specifikimet teknike te mallrave, termat e references dhe preventivi me procesverbalin me nr. nr.4899/1prot,datë 30.06.2026, dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave/sherbimeve. Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Preventivi i hartuara nga KLLFLST si mëposhtë për objektin: "Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit",

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Nr	Emërtimi	Njesia	Sasia
1	Banket	persona	400
2	Koktejl	persona	250
3	Çanta rrobe me logo	copë	100
4	Stilolapsa me logo	copë	100
5	Libra/ dhurata për fëmijë	persona	100
6	Transport	ditë	10
7	Kafe	copë	100
8	Këngëtar	persona	10
9	Kupë	copë	2
10	Shpërblime per artizanët /kulinari	persona	15
11	Kostume animatorësh	copë	2
12	Juria për konkursin e festivalit "Stephanophana"	persona	3

13	Moderator	persona	1
14	Shkrimtarë të njohur	persona	8
15	Postera plastik	copë	2
16	Postera kartoni	copë	5
17	Uji 0.5 L	copë	200
18	Aktor	persona	4
19	Vlerësim për konkursin Stephanophana	persona	1
20	Vlerësim: Eseja më e mirë	persona	1
21	Vlerësim: Videoja më e mirë	persona	1
22	Çertifikata me kapak	copë	40
23	Humorist	persona	1
24	Korniza dekorative	copë	5
25	Medalje "Qytetar Nderi"	copë	5
26	Skenë+foni+ndriçim+ ekran LED	ditë	3
27	Medalje për fituesit e aktiviteteve sportive	copë	20
28	Vlersim për fituesit e kupës "24 Korriku"	persona	15
29	Arbitra (futbolli)	persona	3
30	Lektor	persona	2
31	Degustues vaji ulliri	persona	2
32	Vlerësim për fituesit të vaj ullirit	persona	2
33	Baner	copë	2
34	Vaji ulliri	litra	100
35	Shpërblim për fituesit (sporti)	persona	3
36	Medalje "Njeriu I Vitit"	copë	13
37	Spektakël fishekzjarresh	copë	1
38	Vlersime për fituesit e "Njeriut të Vitit"	persona	13
39	Komisionerët	persona	5
40	Kuti druri dhe shishe vaj ulliri	copë	30
41	Skulptur Vajza Myzeqare	copë	30
42	Libër i Roskovecit "Stephanopha"	copë	30
43	Medalje për fituesit e garës me qerre	copë	4

**GRAFIKU I LËVRIMIT TË SHËRBIMIT PËR OBJEKTIN E PROKURIMEVE ME
OBJEKTIN: "SHPENZIME PËR AKTIVITETE SOCIAL-KULTURORE DHE
SPORTIVE TË VITIT".**

Nr.	Emërtimi i Aktivitetit	Data / Muaji i Zhvillimit
1	Të Njohim Qytetin	Korrik- Dhjetor
2	Promovimi i Librave të Rinj	Shtator–Dhjetor
3	Festivali Letrar “Stephanophana”	3–4 Tetor
4	24 Korriku	22 Korrik-10 Gusht

5	Karriera Frymëzon	Dy herë gjatë vitit
6	Festa e Ullirit	Java e fundit e Tetorit
7	“Njeriu i Vitit”	10–31 Dhjetor

Shërbimet dhe mallrat do të lëvrohen sipas këtyre aktiviteteve dhe sipas kërkesave të tjera të organizatorëve.

Afatet e ekzekutimit:

Duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës mbaron deri më 31.12.2026 ,sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor në përputhje me grafikun e të lëvrimin të shërbimeve.

TERMAT E REFERENCES

Objekti: Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit.

Bazuar ne specifikimet teknike te hartuara nga Bashkia Roskovec për shpenzimet e aktivitetit social-kulturor dhe sportive të vitit.

1. Objekti

Objekti i kësaj procedure është furnizimi me mallra dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike, sportive, promovuese dhe institucionale të Bashkisë Roskovec, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

2. Qëllimi

Qëllimi i kësaj procedure është sigurimi i mallrave dhe shërbimeve me cilësi të lartë, të cilat do të kontribuojnë në organizimin dhe zhvillimin me sukses të aktiviteteve të planifikuara, duke garantuar funksionalitet, cilësi dhe përmbushjen e objektivave të Autoritetit Kontraktor.

3. Përshkrimi i Përgjithshëm

Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin furnizimin me mallra dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për organizimin, koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike, sportive, edukative, promovuese dhe institucionale të Bashkisë Roskovec. Mallrat dhe shërbimet do të përdoren për realizimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit, me qëllim promovimin e kulturës, trashëgimisë, sportit, turizmit dhe jetës sociale në territorin e bashkisë.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë të gjitha mallrat dhe shërbimet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, duke garantuar cilësi, funksionalitet dhe përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike përkatëse. Furnizimi dhe ofrimi i tyre duhet të realizohen në mënyrë të

organizuar, profesionale dhe të koordinuar, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e çdo aktiviteti pa pengesa apo ndërprerje.

Mallrat objekt prokurimi përfshijnë, ndër të tjera, materiale promocionale, artikuj dekorativë, trofe, medalje, certifikata, dhurata, libra, materiale publicitare dhe çdo artikull tjetër të parashikuar në specifikimet teknike. Të gjitha këto produkte duhet të plotësojnë karakteristikat teknike, funksionale dhe estetike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Shërbimet objekt prokurimi përfshijnë organizimin dhe realizimin e shërbimeve të kateringut, transportit, moderimit, animacionit, shfaqjeve artistike, shërbimeve teknike të skenës, fonisë, ndriçimit, ekranit LED, si dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve. Operatori ekonomik duhet të sigurojë personelin, pajisjet, logjistikën dhe mjetet e nevojshme për realizimin e tyre në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Gjatë realizimit të kontratës, operatori ekonomik duhet të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin Kontraktor për koordinimin e çdo aktiviteti, duke iu përgjigjur në kohë kërkesave për furnizime ose shërbime. Ai duhet të jetë në gjendje të përshtatet me ndryshimet që mund të lindin gjatë organizimit të aktiviteteve, pa cenuar cilësinë dhe standardin e mallrave apo të shërbimeve të ofruara.

Të gjitha mallrat dhe shërbimet duhet të jenë në përputhje me standardet përkatëse të cilësisë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e suksesshëm të aktiviteteve të Bashkisë Roskovec. Operatori ekonomik mban përgjegjësi të plotë për cilësinë, funksionalitetin dhe realizimin korrekt të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, duke garantuar që çdo furnizim ose shërbim të përmbushë plotësisht pritshmëritë dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

4. Kërkesat e Përgjithshme

Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të gjitha mallrat dhe shërbimet objekt i kësaj procedure të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike, kërkesat funksionale dhe standardet e cilësisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Mallrat e ofruara duhet të jenë të reja, të papërdorura, të padëmtuara dhe të prodhuara nga materiale cilësore, të cilat garantojnë funksionalitet, jetëgjatësi dhe siguri në përdorim. Ato duhet të kenë karakteristikat teknike të kërkuara në dokumentacionin e tenderit dhe të jenë të përshtatshme për përdorimin për të cilin prokurohen. Në rast se për kategori të caktuara mallrash kërkojnë certifikata cilësie ose dokumente që vërtetojnë origjinën dhe standardet e prodhimit, operatori ekonomik duhet t'i disponojë dhe t'i paraqesë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Për shërbimet, operatori ekonomik duhet të sigurojë personel me kualifikimin, eksperiencën dhe aftësitë profesionale të nevojshme për realizimin e tyre. Personeli duhet të jetë i aftë të kryejë detyrat në mënyrë profesionale, duke respektuar kërkesat organizative, teknike dhe logjistike të çdo aktiviteti.

Pajisjet, materialet dhe mjetet që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, funksionale dhe të përshtatshme për përdorim, duke garantuar zhvillimin normal të aktiviteteve pa ndërprerje apo probleme teknike.

Operatori ekonomik është përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha proceseve që lidhen me furnizimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve. Ai duhet të marrë të gjitha masat organizative dhe teknike për të garantuar realizimin e kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Çdo mall ose shërbim që nuk përmbush specifikimet teknike, paraqet mangësi cilësore ose nuk përputhet me kërkesat e Autoritetit Kontraktor, do të konsiderohet i papranueshëm. Në këto raste operatori ekonomik është i detyruar të bëjë zëvendësimin e mallit ose të ripërsërisë shërbimin, pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor dhe brenda afatit të kërkuar prej tij.

Operatori ekonomik duhet të garantojë bashkëpunim të vazhdueshëm me Autoritetin Kontraktor gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, duke caktuar persona përgjegjës për komunikimin, koordinimin dhe zgjidhjen në kohë të çdo kërkesë apo problematike që mund të lindë gjatë realizimit të aktiviteteve.

Në realizimin e kontratës, operatori ekonomik duhet të respektojë standardet profesionale, rregullat e sigurisë në punë, normat higjieno-sanitare, si dhe çdo kërkesë tjetër teknike që lidhet me natyrën e mallrave dhe shërbimeve objekt prokurimi.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë në çdo moment cilësinë, karakteristikat teknike dhe përputhshmërinë e mallrave dhe shërbimeve me kërkesat e kontratës dhe specifikimet teknike. Në rast konstatimi të mospërputhjeve, operatori ekonomik është i detyruar të marrë menjëherë masat korrigjuese të kërkuara.

Operatori ekonomik duhet të garantojë që të gjitha mallrat dhe shërbimet e ofruara do të kontribuojnë në zhvillimin normal, të sigurt dhe me cilësi të aktiviteteve të planifikuara nga Autoriteti Kontraktor, duke siguruar një nivel të lartë profesionalizmi dhe besueshmërie gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: